

 <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<b>Politika për nënkontraktimet e vlerësimeve</b>	Kodi DA-PO-006
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 1 nga 1

## Politika për nënkontraktimet e vlerësimeve

### 1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Akreditimit në lidhje me nënkontraktimin e vlerësimit, kushtet në të cilat ajo do të kryhet për te përmbushur kërkesat e palëve të interesuara dhe detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi.

### 2. Referimet

Standardi ISO/IEC 17011, paragrafi 7.4.1 “Kërkesa të përgjithshme për organizmat e akreditimit që akreditojnë organizmat e vlerësimit të konformitetit.

### 3. Politika

Të gjitha nënkontraktimet, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e vlerësimit në procedurat e akreditimit, duhet të dokumentohen me anën e marrëveshjes ndërmjet DA dhe nënkontraktuesit e cila mbulon gjithë rregullimet duke përfshirë konfidencialitetin dhe konfliktin e interesave.

Drejtoria e Akreditimit ka përgjegjësi të plotë për punën e nënkontraktuar dhe mban përgjegjësi për vendimin e akreditimit që përfshin dhënien, mbjatjen, zgjerimin, reduktimin, pezullimin dhe tërheqjen e akreditimit.

Drejtoria e Akreditimit ka përgjegjësi që organizmi i nënkontraktuar është kompetent dhe plotëson kërkesat e dhëna për vlerësimin që duhet të kryej. Gjithashtu nënkontraktori nuk duhet të jetë i përfshirë direkt apo indirekt në skema vlerësimi të cilat çenojnë paanëshmërinë dhe pavarësinë.

Drejtoria e Akreditimit do të marrë miratimin e aplikantit për vlerësimin e nënkontraktuar.

**Datë**

**Drejtori i Përgjithshëm**